



ANNUAL REPORT
RAPORT VJETOR

2008

ANNUAL REPORT
RAPORT VJETOR

2008

Content

Përmbajtja

Message form the Chairman	7	Mesazhi i Kryetarit
New Chairman's Message	9	Mesazhi i Kryetarit të Ri
Milestones for 2008	11	Ngjarje të Rëndësishme për vitin 2008
AAB Organizational Chart	12	Struktura Organizative e AAB-së
AAB Executive Committee	13	Bordi Drejtues
Albanian Banking System during 2008	14	Sistemi Bankar Shqiptar gjatë vitit 2008
AAB Activity	17	Aktiviteti i AAB-së
<ul style="list-style-type: none"> • Legal & Regulatory Framework Initiatives <ul style="list-style-type: none"> - Changes and amendments to Civil Procedure Code (about the collateral enforcement) - VAT Reverse Charge issue - Bank of Albania's set of transparency draft regulations - Bank of Albania's draft Regulation: "On the minimal technical and security terms of work premises in the entities running banking and financial activity" • Improving operational infrastructure of Register of Security Charges • Improving banking system information <ul style="list-style-type: none"> - AAB Quarterly Newsletters • Improvement of AAB organizational capabilities and administrative functioning • Satisfying banks' training needs with quality and cost-effective opportunities • Promotion & Marketing • Establishment of Special Projects Initiative (SPI) Albania • Domestic Events & International Presences 	17	<ul style="list-style-type: none"> • Nismat Ligjore dhe Rregullatore <ul style="list-style-type: none"> - Shtesat dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile (lidhur me ekzekutimin e kolateralit) - Autofaturimi i TVSH-së - Projektregulloret e Bankës së Shqipërisë mbi transparencën - Projektregulloja e Bankës së Shqipërisë: "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare" • Përmirësimi i Infrastrukturës Operacionale të Regjistrimit të Barrave Siguruese • Përmirësimi i Sistemit të Raportimit të të Dhënave Bankare <ul style="list-style-type: none"> - Buletinet informative Tremujore të AAB-së • Përmirësimi i Kapaciteteve Organizative dhe Administrative të AAB-së • Përmirësimi i Kërkesave të Bankave për trajnime Cilësore dhe me Kosto të Ulët • Promovimi & Marketingu • Mbështetja dhe krijimi i Nismës për Projekte të Veçanta (SPI –Albania) • Aktivitete brenda Vendi & dhe Pjesëmarrjet Ndërkombëtare • Konsulencat
AAB Profile	28	Profili i AAB-së
Secretariat Profile	29	Profili i Sekretariatit
AAB Financial Activity	31	Aktiviteti Financiar i AAB-së
Profile of Banks in Albania	40	Profili i Bankave në Shqipëri





Mr. Edvin Libohova
Chairman - Kryetar

Message from the Chairman

Mesazh i Kryetarit

Dear Colleagues,

The year 2008 marks another good year for AAB towards further consolidation and strengthening of the Albanian Banking System, which managed to face with regional and global challenges.

Our banking system proved successfully to be capable of weathering the effects of global economic and financial crisis and furthermore, the measures taken in this regard, guarantee a normal performance for 2009 and beyond.

The banking system, during 2008, maintained a satisfactory level of growth in all its indicators: the assets increased by more than 12%, credit portfolio surpassed EUR 3 billion, retail banking network expanded by more than 25% with 125 outlets, more than 1,100 new employees joined the industry, and above all, the system was profitable and well-capitalized.

Along with these achievements by the banking system, AAB itself has been so successful in accomplishing its objectives and shaping a bold profile abroad. AAB has successfully:

- lobbied for proper changes and amendments to the regulatory framework, especially with interventions at Civil Procedure Code, about the collateral enforcement issue,
- organized, for the first time, a significant international event like: EBF meetings in Tirana,
- supported and contributed to the first public-

Te nderuar kolege,

Për Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB), viti 2008 përbën një tjetër vit arritjesh, drejt forcimit dhe konsolidimit të sistemit bankar në Shqipëri, plotësisht i aftë të përballojë me sukses sfida me përmasa rajonale e globale.

Efektet e krizës globale që përfshinë pothuajse mbarë globin, u përballuan me sukses nga sistemi ynë bankar dhe sistemi i masave të marra garantojnë plotësisht një ecuri normale për vitin 2009 dhe më tej.

Sistemi ynë bankar gjatë vitit 2008 vazhdoi të ruajë ritme të kënaqshme zhvillimi, në të gjithë treguesit e tij: mjetet u rritën me mbi 12 për qind, portofoli i kredisë tejkaloi mbi 3 miliard EURO, rrjeti bankar u zgjerua me më shumë se 25 për qind me 125 degë dhe agjenci si dhe mbi 1,100 punonjës të rinj iu bashkuan sistemit bankar; mbi të gjitha, sistemi ishte fitimprurës dhe i mirëkapitalizuar.

Ndërkohë, si arritje të veçanta për Shoqatën Shqiptare të Bankave, përveç përmbushjes së objektivave dhe rritjes së profilit të saj ndërkombëtar, do të përmendja:

- lobimi i suksesshëm për kryerjen e shtesave dhe ndryshimeve të duhura në kuadrin rregullator, veçanërisht lidhur me ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, mbi ekzekutimin e kolateralit,
- organizimin, për herë të parë, të një evenimenti të rëndësishëm ndërkombëtar si: mbledhjet e

private initiative, with the establishment of SPI Albania,

- enhanced the information platform, by way of publishing AAB Quarterly Newsletter,
- increased AAB organizational & professional capabilities by establishing two other technical committees, etc.

I am fully convinced that, with Mr. Libero Catalano as the new Chairman, AAB will for sure increase its active role, by providing more support for the entire banking system activity in Albania.

Thanking for your kind support and cooperation,

Respectfully,



Edvin Libohova
Chairman

Federatës Evropiane të Bankave në Tiranë,

- mbështetja dhe kontributi për krijimin e SPI Albania, si e para nismë bashkëpunimi midis sektorit publik dhe privat,
- zgjerimi i platformës së informimit publik, nëpërmjet publikimit të Buletinit Tremujor të AAB-së,
- rritja e kapaciteteve profesionale dhe organizative të AAB-së, nëpërmjet krijimit të dykomiteteve të tjera të përhershme teknike, etj.

Jam i bindur se, ardhja në krye të AAB-së e z.Libero Catalano do të rrisë më tej rolin aktiv të saj, në mbështetje të mirë funksionimit të sistemit bankar në Shqipëri.

Duke ju falenderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin,

Me respekt,



Edvin Libohova
Kryetar



Mr. Libero Catalano
Chairman - Kryetar

New Chairman's Message

Mesazhi i Kryetarit të ri

Dear Colleagues,

It gives me a unique pleasure to address you in the capacity of the new AAB Chairman. Firstly, I would like to warmly thank all the Assembly and member Banks for the full trust given to me to chair the Albanian Association of Banks in this very special moment.

I am fully convinced that during my mandate AAB will continue to follow in the valuable experience gained so far, thanks to the visionary management of its outstanding past Chairmen and AAB dedicated Staff and will even go further bolstering its profile and authority in a quite remarkable way.

Now we see AAB acting as an institutional partner with the Authorities and other Organizations, by representing and upholding the Albanian Banking system's interests with an admirable competence, as well as a quality information point for members and public in general.

During my mandate I commit to accomplish with your valuable support, among other targets, important objectives like:

- *an ever-increasing cooperation with Bank of Albania and other key public & private Institutions, aiming at making AAB an indispensable interlocutor for all banking issues;*
- *promoting the collaboration between member Banks, by encouraging the development of the money market and its respective instruments and other forms of partnerships;*
- *supporting professional financial education for*

Të nderuar Kolegë,

Është një kënaqësi e vacantë për mua t'ju drejtohem juve në cilësinë e Kryetarit të ri të AAB-së. Dëshiroj të falenderoj ngrohtësisht Asamblenë e AAB-së dhe bankat anëtare për besimin e plotë që më dhanë për drejtimin e AAB-së, në këtë moment të veçantë, kur profili dhe autoriteti i vetë AAB-së është fuqizuar dukshëm, falë drejtimit vizionar të kryetarëve të mëparshëm dhe stafit të përkushtuar të AAB-së.

Tashmë AAB funksionon si një partner institucional me autoritetet vendase dhe grupet e tjera të interesit, duke përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e sistemit bankar, me një kompetencë të admirueshme, dhe si një qendër informacioni cilësor për anëtarët e saj dhe publikun e gjerë.

Shpreh bindjen dhe angazhohem se, gjatë mandatit tim AAB do të vijojë të ecë në rrugën e deritanishme, duke shfrytëzuar të gjithë eksperiencën e vlefshme të grumbullar në vite, si dhe do të shkojë më tej, duke synuar përmbushjen e disa objektivave të rëndësishme, si më poshtë:

- *rrijten e vazhdueshme të nivelit të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë dhe institucioneve të tjera të rëndësishme, publike dhe private, me synim kthimin e AAB-së në një interlocutor të domosdoshëm lidhur me të gjithë çështjet bankare;*
- *promovimin e bashkëpunimit midis bankave anëtare, nëpërmjet nxitjes dhe ndihmesës për zhvillimin e tregut të parasë dhe instrumenteve të tij respektivë;*
- *mbështetjen e edukimit financiar profesional të*

Albanian bankers and establishing the basis for a banking academy.

AAB is devoted to be a proactive player within banking industry, thus making its best contribution towards further development and modernization of the Albanian Banking System.

I wish you all success and prosperity.

Sincerely,



Libero Catalano

bankierëve shqiptarë dhe krijimit të platformës për themelimin e akademisë bankare.

AAB mbetet e vendosur për të qenë një institucion proaktiv, në kuadrin e industrisë bankare, duke dhënë kështu kontributin e saj më të mirë, në drejtim të zhvillimit dhe modernizimit të mëtejshëm të Sistemit Bankar Shqiptar.

Duke ju uruar suksese.

Sinqerisht,



Libero Catalano

Milestones for 2008

Ngjarje të rëndësishme për 2008


1. Approval of changes and amendments to Civil Procedure Code, regarding some of critical issues, about the collateral enforcement in Albania, mainly according to banking system's recommendations and opinions;
 2. Publication of AAB Quarterly Newsletter;
 3. Successful organization, for the first time in Albania, of EBF¹ Meetings of the Executive Committee and of the Associates.
 4. Establishment of two other permanent technical committees (AAB Bank Security Committee and AAB Payment Systems' Committee);
 5. Providing financial support for the new software for the Register of Security Charges;
 6. Efficient lobbying for the banking system, for fiscal and regulatory issues;
 7. Organizing and supporting numerous workshops and seminars for Albanian bankers on different banking topics, as well as international events;
 8. Successful commencement of SPI Albania activity and its consolidation throughout 2008.
1. Miratimi i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile, për disa çështje të rëndësishme kritike, lidhur me ekzekutimin e kolateralit në Shqipëri, të mbështetura kryesisht mbi rekomandimet dhe opinionet e dhëna nga sistemi bankar;
 2. Publikimi i Buletinit tremujor të AAB-së;
 3. Organizimi i suksesshëm, për herë të parë në Shqipëri, i mbledhjeve të Komitetit Ekzekutiv dhe të Anëtarëve të Asociuar të Federatës Evropiane të Bankave (EBF)¹;
 4. Ngritja e dy komiteteve të tjera të përhershme (Komiteti i Sigurisë Bankare dhe Komiteti i Sistemeve të Pagesave të AAB-së);
 5. Financimi i *software*-t të ri për Regjistrin e Barrave Siguruese, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë & Energjetikës;
 6. Lobing i frytshëm për sistemin bankar, lidhur me çështjet fiskale dhe ato rregullatore;
 7. Organizimi dhe mbështetja e shumë takim-diskutimeve dhe seminareve për bankierët shqiptarë, mbi tema dhe çështje të ndryshme bankare, si dhe evenimente ndërkombëtare;
 8. Fillimi i suksesshëm i aktivitetit të SPI Albania dhe konsolidimi i saj gjatë vitit 2008.

¹EBF – European Banking Federation

¹EBF – Federata Evropiane e Bankave

AAB Organizational Chart

Skema organizative e AAB-së



AAB Executive Committee

Bordi Drejtues i AAB

**Mr. Edvin LIBOHOVA**

Chairman of the Management Board
BANKA POPULLORE
Chairman

Kryetar i Bordit Drejtues
BANKA POPULLORE
Kryetar i Bordit Drejtues

**Mr. Libero CATALANO**

Chief Executive Officer
ITALIAN DEVELOPMENT BANK (BIS)
Vice Chairman

Drejtor Ekzekutiv
BANKA ITALIANE E ZHVILLIMIT (BIS)
Nënkryetar i Bordit Drejtues

**Mr. Seyhan PENCAPLIGIL**

Chief Executive Officer
BANKA KOMBËTARE TREGTARE
Member

Drejtor Ekzekutiv
BANKA KOMBËTARE TREGTARE
Anëtar

**Mr. Abdul Waheed ALAVI**

Chief Executive Officer
UNITED BANK OF ALBANIA
Member

Drejtor Ekzekutiv
BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE
Anëtar

**Mr. Oliver WHITTLE**

Chief Executive Officer
RAIFFEISEN BANK
Member

Drejtor Ekzekutiv
BANKA RAIFFEISEN
Anëtar

Albanian Banking System during 2008

Sistemi Bankar Shqiptar gjatë vitit 2008

Indicator - Treguesi	2007	2008
Total assets - Totali i Mjeteve (mln EUR)	6,100	6,730
<i>in % of GDP – në % të PBB-së</i>	75.90%	78%
Total Deposits – Totali i Depozitave (mln EUR)	5,174	5,206
<i>in % of GDP – në % të PBB-së</i>	64.38%	60.40%
Retail Deposits - Depozita të individëve (mln EUR)	4,223	4,272
<i>in % of GDP – në % të PBB-së</i>	52.55%	49.50%
Credit to Economy - Kredia për Ekonominë (mln EUR)	2,416	3,202
<i>in % of GDP – në % të PBB-së</i>	29.90%	37.10%
Corporate loans - Huatë për Biznes (mln EURO)	1,570	2,072
Retail loans - Huatë për individë (mln EURO)	846	1,130
Shareholders' Equity - Kapitali Aksioner (mln EUR)	465.0	576.7

Source: Bank of Albania

Burimi: Banka e Shqipërisë

The year 2008 was another good year for the Albanian banking system, despite the burst of global economic & financial crisis, by September 2008. It continued to develop progressively in all parameters.

Deposits continued to increase steadily until September, when they peaked more than EUR 5.6 billion, to close the year at EUR 5.2 billion, with an increase of 2.4 per cent compared to 2007.

Viti 2008 ishte një vit tjetër pozitiv për sistemin bankar shqiptar, pavarësisht shpërthimit, në shtator 2008, të krizës globale ekonomike dhe financiare. Ai vazhdoi të zhvillohej pozitivisht në të gjithë parametrat e tij.

Depozitat vijuan të rriten në mënyrë të vazhdueshme deri në shtator, kur arritën në 5.6 miliard EURO, duke mbyllur vitin në 5.2 miliard EURO, me një rritje prej 2.4 për qind, krahasuar me 2007.

Indicator - Treguesi	2007	2008
Cards: - Kartat:	616,375	512,232
Debit – debiti	603,384	480,072
Credit – krediti	12,991	15,931
<i>Cashtronic – vetëm për tërheqje parash</i>		14,229
No of ATM – Nr. i ATM-ve	433	642
No. of POS – Nr. i POS-eve	1,776	2,953

Source: Bank of Albania

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bank's assets rose nearly 12.3 per cent, thus reaching more than 78 per cent of GDP.

The most significant indicator, credit to economy, rose again to a record level, by going beyond the EUR 3 billion mark, at EUR 3.2 billion, thus reaching 37 per cent of GDP. An important development is the balanced growth rate of both corporate and retail loans, which grew by more than 32 per cent each.

The ever-increasing shareholders' equity fund, ensured the liquidity cushion, which weathered the external shocks of global crisis, as well the supply base to finance the vibrant credit growth to economy.

Banks increased the number of ATMs and POS significantly, along with their retail network, by providing the general

Mjetet e bankave u rritën me rreth 12.3 për qind, duke arritur në mbi 78 për qind të PBB-së.

Treguesi më i rëndësishëm, kredia për ekonominë, arriti përsëri në një nivel rekord, duke tejkaluar kufirin e 3 miliard EURO, saktësisht 3.2 miliard EURO, ose 37 për qind të PBB-së. Një zhvillim i rëndësishëm në këtë aspekt ishte rritja e balancuar e huave për biznes dhe atyre për individë, të cilat u rritën me më shumë se 32 për qind secila.

Rritja e vazhdueshme e kapitalit aksioner, shërbeu jo vetëm për përballimin më së miri të goditjeve të jashtme të krizës globale, por dhe si një mbështetje e madhe për financimin e rritjes së fortë të kredisë për ekonominë.

Bankat rritën në mënyrë të ndjeshme numrin e ATM-ve dhe POS-ve, si dhe rrjetin e degëve dhe agjencive të tyre,

Indicator – Treguesi		2007	2008
No. of bank employees	Nr. i punonjësve në banka	5,206	6,332
Number of bank outlets	Nr. i degëve dhe agjencive bankare	392	517
Number of residents per:	Nr. i banorëve për:		
- bank	- bankë	186,235	198,128
- bank unit	- njësi bankare	8,077	6,132
- bank employee	- punonjës banke	608	501

Source: AAB

Burimi: AAB

public and businesses with more access to banking and financial services and products.

The year 2008 was the first full year for the Credit Register to operate within Albanian Banking system, thus helping them making more informed credit decisions and alleviating problematic customers.

Banks started to adopt their systems for the introduction of IBAN for both domestic and international payments. IBAN is projected to be fully operational by 01 June 2009.

duke i ofruar publikut të gjerë dhe bizneseve një akses më të madh në shërbimet dhe produktet bankare e financiare.

Viti 2008 ishte viti i parë i plotë i funksionimit të Regjistrimit të Kredive, duke i ndihmuar bankat në marrjen e vendime më objektive, duke shmangur klientët problematikë.

Bankat filluan të përshtasin sistemet e tyre për përdorimin e IBAN-it, si për pagesat kombëtare, ashtu dhe ato ndërkombëtare. IBAN-i mendohet të jetë plotësisht operacional nga 1 qershori 2009.



AAB Activity

Aktiviteti i AAB-së

AAB was mainly focused on the main objectives and priorities, set out by AAB Executive Committee, where the most important ones were:

Aktiviteti i AAB-së gjatë këtij viti u fokusua në përmbushjen e objektivave dhe prioriteteve kryesore, të vendposura nga Brodi Drejtues i AAB-së, ndër të cilat mund të përmenden:

Legal & Regulatory Framework Initiatives

Nismat Ligjore dhe Rregullatore

Changes and amendments to Civil Procedure Code (about the collateral enforcement)

AAB was invited at the hearing session with the Albanian Parliament (Parliamentary Commission for Legal Affairs), about the new draft law on changes and amendments to the Civil Procedure Code (mainly concerning the collateral enforcement issue). This followed the persistent work, initially done by AAB Secretariat itself for more than three years, then continued with the support of SPI Secretariat and Project Working Group of SPI Albania for Foreclosure and Bailiff's office issues.

Almost all technical proposals (more than 95%) made by AAB – SPI joint team, were included in the proposed draft law by the Government. The Parliament approved the new Law on 11 December 2008, where 10 out of 14 proposals new included (all key proposals were approved), thus allowing the banking system to enter a new phase of less bureaucratic and time & money-consuming foreclosure procedures. The new law will lead to an easing of the risk associated with bank loans (especially mortgage ones), therefore lowering the risk premium and respective final interest rate, payable by banks' clients.

Shtesat dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile (lidhur me ekzekutimin e kolateralit)

AAB u ftua në seancën degjimore të Kuvendit të Shqipërisë (Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore), lidhur me projektligjin e ri mbi disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, (çështje që lidheshin kryesisht me ekzekutimin e kolateralit). Ky hap kurorëzoi një punë këmbëngulëse mbi trevjeçare, fillimisht nga vetë Sekretariati i AAB-së, për të vazhduar më tej dhe me mbështetjen e Sekretariatit të SPI Albania dhe grupit respektiv të punës për çështjet lidhur me ekzekutimin e kolateralit dhe procedurat përmbartimore.

Thuajse të gjithë propozimet teknike (më shumë se 95%), të ofruara nga AAB dhe SPI, u përfshinë në projektligjin e propozuar nga Qeveria. Kuvendi miratoi ligjin e ri më 11 dhjetor 2008, ku 10 nga 14 propozime u përfshinë (të gjitha propozimet kryesore u miratuan), duke i dhënë mundësi sistemit bankar të hyjë në një fazë të re procedurash ekzekutimi të detyrueshëm, me më pak burokraci dhe kosto më të ulta. Ligji i ri do të çojë reduktimin e rrezikut që shoqëron kreditë bankare (veçanërisht ato hipotekore), duke ndikuar kështu në zvogëlimin e faktorit të rrezikut në përgjithësi dhe normave përfundimtare të interesit, që do të paguheshin nga klientët e bankave.

VAT Reverse Charge issue

AAB Secretariat organized several technical meetings with bank specialists, about the issue of VAT Reverse Charge, which would be applied on all imported goods and services by banks. Following professional discussions and consultations, AAB Secretariat proposed and presented to the Ministry of Finance an official list of bank services, which should be classified as financial services and therefore are not qualified for VAT reverse charge purposes¹.

Bank of Albania's set of transparency draft regulations

AAB was engaged in the discussion process about the set of transparency draft regulations, proposed by Bank of Albania, practically the Regulations: "On the transparency of banking products and services" and "On minimum requirements for disclosure of information by banks and branch of a foreign bank". AAB organized a technical workshop, where many aspects of these important regulations were discussed (please see section "Domestic Events & International Presences"). Also, at the workshop some respective changes and amendments to the existing regulations, were discussed, as follows:

- "On credit risk administration", mainly related to unhedged borrowers,
- "On capital adequacy",
- "On risk administration at foreign bank branches".

Bank of Albania's draft Regulation: "On the minimal technical and security terms of work premises in the entities running banking and financial activity"

AAB discussed, through its Bank Security Committee, the new draft regulation of Bank of Albania: "On the minimal technical and security terms of work premises in the entities being licensed from the Bank of Albania". Following the discussions a major part of AAB proposals were included in the final regulation.

Autofaturimi i TVSH-së

Sekretariati i AAB-së organizoi disa takime teknike me specialistë të bankave, lidhur me çështjen e autofaturimit të TVSH-së, që duhej zbatuar mbi të gjithë mallrat dhe shërbimet e importuara nga bankat. Pas diskutimeve dhe konsultimeve profesionale, Sekretariati i AAB-së propozoi dhe paraqiti zyrtarisht pranë Ministrinë e Financave një listë të shërbimeve bankare, të cilat duhet të klasifikohen si shërbime financiare e për rrjedhojë, të mos autofaturohet TVSH.

Projektregulloret e Bankës së Shqipërisë mbi transparencën

AAB u angazhua në një proces diskutimi mbi grupin e projektregulloreve të transparencës, të propozuara nga Banka e Shqipërisë, konkretisht projektregulloret: "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare" dhe "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja". AAB organizoi një takim-diskutimi në nivel teknik, në të cilin u diskutuan shumë aspekte të këtyre projektregulloreve të rëndësishme (shiko seksionin: "Aktivitetet brenda vendit & Pjesëmarrjet ndërkombëtare"). Gjithashtu, në këtë takim-diskutimi u diskutuan dhe disa shtesa e ndryshime në rregulloret ekzistuese, si rregulloret:

- "Për administrimin e rrezikut të kredisë", kryesisht i lidhur huamarrësit e pambrojtur,
- "Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit",
- "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja".

Projektregullorja e Bankës së Shqipërisë: "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare"

AAB, nëpërmjet Komitetit të saj për Sigurinë Bankare, diskutoi mbi projektregullore e re të Bankës së Shqipërisë: "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare". Në dokumentin përfundimtar të rregullores, u përfshinë shumica e propozimeve të AAB-së.

¹ The proposed list by AAB was successfully approved by the Minister of Finance on February 2009.

¹ Lista e propozuar nga AAB-ja u aprovua me sukses nga Ministri i Financave në shkurt 2009.

Improving operational infrastructure of Register of Security Charges

Përmirësimi i infrastrukturës operacionale të Regjistrit të Barrave Siguruese

Following the request by the Ministry of Economy, Trade & Energy (METE) for a potential AAB financial support to develop and implement new software, regarding the Register for Security Charges, AAB, upon the Executive Committee and then AAB Assembly support, funded this initiative. It is intended to help banks in their everyday loan making activity, by replacing the old software.

Në vijim të kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë & Energjetikës (METE), mbi ofrimin nga sistemi bankar, nëpërmjet AAB-së, të një mbështetjeje financiare për zhvillimin e një programi të ri kompjuterik për Regjistrin e Barrave Siguruese, AAB me miratim të Bordit Drejtues dhe Asamblesë realizoi në praktikë financimin e kësaj nisme. Ky program synon të lehtësojë aktivitetin e përditshëm kredidhënës të bankave, duke zëvendësuar programin aktual.

Improving banking system information

Përmirësimi i Sistemit të Raportimit të të Dhënave Bankare

AAB Quarterly Newsletters

AAB Sekretariat, pursuing the objective set by AAB Executive Committee to issue a periodic information bulletin, prepared for the first time, the AAB Newsletter, which is published on a quarterly basis. This bulletin is mainly intended to provide all banks, other stakeholders and general public with updated information about AAB activity and forthcoming events, to be organized in the future. Also, an important part of this bulletin are the most recent data about the Albanian banking industry.

Buletinet Informative Tremujore të AAB-së

Sekretariati i AAB-së, në vijim të objektivit për botimin e një buletini informativ periodik, përgatiti dhe botoi, për herë të parë, Buletinin Informativ të AAB-së (AAB Newsletter), i cili botohet një herë në tre muaj. Ky buletini synon që t'u japë bankave, grupeve të tjera të interesit si dhe publikut të gjerë një informacion të përditësuar mbi veprimtarinë e AAB-së, si dhe një pasqyrë të aktiviteteve që AAB do të organizojë në vijim. Gjithashtu, një pjesë e rendësishme e këtij buletini është dhe të dhënat kryesore (financiare) më të fundit mbi sistemin bankar shqiptar.

Improving AAB organizational capabilities and administrative functioning

Përmirësimi i kapaciteteve organizative dhe funksionimit administrativ të AAB

Following the AAB overall guideline for optimization of its organizational capabilities, AAB Executive Committee approved during 2008 the establishment of two other permanent committees: AAB Bank Security Committee ((initially headed by Mr. Ilir Curraj, of Banka Popullore) and AAB Payment Systems' Committee Legal Committee. These are technical committees and are created under the structure of AAB Sekretariat and aim at raising the professional profile of AAB itself, as well as addressing different banking issues in a cost-effective way, by using the already available expertise, provided by professional bankers.

Në vijim të objektivave të AAB-së për zgjerimin dhe optimizimin e kapaciteteve të saj organizative, Bordi Drejtues i AAB-së, aprovoi gjatë vitit 2008, krijimin dhe të dy komiteteve të tjera të përhershme: Komiteti i Sigurisë Bankare (me kryetar z. Ilir Curraj, nga Banka Popullore) dhe Komiteti i Sistemeve të Pagesave. Këto janë komitete teknike, të krijuar si pjesë e strukturës së Sekretariatit të AAB-së, me qëllim ngritjen e profilit profesional të AAB-së, si dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme bankare në mënyrë sa më efektive, duke përdorur eksperiencën e vetë ekspertëve të bankave.

Satisfying banks' training needs with quality and cost-effective opportunities

Përmbushja e kërkesave të bankave për trajnime cilësore dhe me kosto të ulët

AAB organized many training seminars, technical workshops and meetings, in partnership with various institutions like: Bank of Albania, Albanian Deposit Insurance Agency (ASD), International Financial Corporation (IFC), LGPA (USAID) office and GTZ (please see section "**Domestic Events & International Presences**", for more information).

AAB organizoi shumë seminare trajnuese dhe takime-diskutimi në nivel teknik, në bashkëpunim me institucionet të tilla si: Banka e Shqipërisë, Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), IFC, zyrën e LGPA (USAID) dhe GTZ (shihni seksionin: "**Aktivitetet brenda vendit & Pjesëmarrjet ndërkombëtare**", për më shumë informacion).

Promotion & Marketing

Promovimi & Marketingu

AAB Quarterly Newsletter.

AAB began to publish its quarterly newsletter with detailed information about AAB activity and events, as well as useful data and figures about the Albanian Banking system.

Buletini Informativ Tremujor i AAB-së.

AAB filloi gjatë 2008 publikimin e buletinit të saj informativ me të dhëna mbi aktivitetin dhe organizimet e AAB-së, si dhe të dhëna të nevojshme mbi sistemin bankar shqiptar.

AAB webpage included in Internet Securities Bulgaria website

AAB webpage has been included in the Internet Securities Bulgaria (trading as ISI Emerging Markets: www.securities.com), which is part of EUROMONEY INSTITUTIONAL INVESTOR Group, as an official data source for the Albanian Banking System. This is a portal which offers comprehensive business and economic information, covering all Balkans Region. ISI clients would have access to some public business information available free of charge on AAB website (e.g. publications) via ISI web service.

Faqja e internetit të AAB-së përfshihet në faqen e internetit të "Internet Securities – Bulgaria".

Faqja e internetit të AAB-së u përfshi në faqen e internetit të "**Internet Securities – Bulgaria**", (që tregtohet si ISI Emerging Markets: www.securities.com), pjesë e Grupit "EUROMONEY INSTITUTIONAL INVESTOR", në statusin e burimit zyrtar të të dhënave mbi sistemin bankar shqiptar. Kjo faqe interneti ofron informacione të zgjeruara biznesi dhe ekonomike, mbi rajonin e Ballkanit. Klientët e ISI mund të kenë akses në të dhënat dhe informacionet, që AAB publikon falas në faqen e saj të internetit, nëpërmjet faqes së internetit të ISI-së.

Organizing “KRUJA” photo exhibition, at the Annual EBF Cocktail, in Brussels, BELGIUM.

At the Annual EBF Cocktail, 04 December 2008, in Brussels, BELGIUM, AAB supported and organized, for the first time, a photo exhibition with professional pictures, shot by Ms. Viktorija Proskurovska, EBF adviser, during her stay in Tirana, on the occasion of EFB Meetings, on 5-6 June 2008, in Tirana. At the exhibition, many professional pictures from historic city of Kruja were displayed. The event was attended by numerous people of European financial industry and institutions, located in Brussels.

Some of the pictures displayed at the exhibition are shown throughout this annual report.

Organizimi i ekspozitës fotografike “KRUJA”, në kuadrin e Koktejlit të Përvitshëm, të organizuar nga EBF në Bruksel, BELGJIKË.

Në Kotejlin e Përvitshëm të EBF-së në 04 dhjetor 2009, në Bruksel, Belgjikë, u hap për herë të parë ekspozita fotografike “KRUJA”, e mbështetur dhe sponsorizuar nga AAB, me foto të znj. Viktorija Proskurovska, këshilltare pranë EBF-së, të realizuara gjatë qëndrimit të saj në Tiranë, në kuadër të takimeve të Komitetit Ekzekutiv dhe të Anëtarëve të Asociuar të EFB-së, në 5 - 6 qershor 2008, në Shqipëri. Ekspozita e ndoq nga mjaft personalitete të industrisë dhe institucioneve financiare Evropiane, me seli në Bruksel.

Disa prej fotove të kësaj ekspozite, janë paraqitur edhe në këtë raport vjetor.

Establishment of Special Projects Initiative (SPI) Albania

Mbështetja dhe krijimi i Nismës për Projekte të Veçnata (SPI –Albania)

AAB, in partnership with Bank of Albania and Convergence Program of the World Bank supported the establishment, at AAB premises, of SPI Albania as the first public-private initiative, with the objective to modernize the Albanian financial sector, by way of developing a culture of dialogue and consensus building within its financial policy making environment.

SPI Albania² is intended to assist AAB and banking community to formulate various proposals and projects, in relation to improvement of regulatory framework affecting banking industry, according to European standards.

AAB, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Programin “Convergence” të Bankës Botërore, mbështetën dhe krijuan, pranë ambienteve të AAB-së, SPI Albania² si një nismë e bashkëpunimit publik-privat, me objektin modernizimin e sistemit financiar shqiptar, nëpërmjet zhvillimit të kulture dialogu dhe ndërtimit të konsensusit brenda mjedisit vendimmarrës për politikën financiare.

SPI Albania synon të ndihmojë AAB-në dhe komunitetin bankar në formulimin e projekteve dhe propozimeve të ndryshme, lidhur me përmirësimin e kuadrit rregullator, që lidhet me industrinë bankare në përputhje me standardet evropiane.

² More information about SPI Albania activity is found by following this link: <http://www.spi-albania.eu>

² Më shumë informacion mbi aktivitetin e SPI Albania mund të gjeni duke klikuar në: <http://www.spi-albania.eu>

Domestic Events & International Presences

Aktivitetet brenda vendit & Pjesëmarrjet ndërkombëtare

Domestic Events & Seminars

AAB Secretariat, as part of its activity, organized and co-organized the following domestic events, workshops and seminars:

AAB – BoA joint workshop on the newest of transparency draft regulations

AAB and BoA's Supervision Department organized on 23 June 2008, a discussion-based workshop on some draft regulations prepared by BoA, as follows:

- "On the transparency of banking products and services",
- "On minimum requirements for disclosure of information by banks and foreign bank branches".

The workshop was focused on the following topics:

- Calculation method for effective interest rate;
- Draft amendments related to the enforcement of measures regarding credit risk administration;
- Some other steps and opportunities for IFRS implementation by banks, the applied methods by banks, in relation to IFRS standards' implementation and the importance of prudential reporting.

AAB – ASD regional training workshops: "Public awareness on Deposit Insurance in Albania".

Albanian Association of Banks, in cooperation with Albanian Deposit Insurance Agency (ASD) organized, during 2008, five regional training workshops, respectively in Tirana, Vlora, Saranda Shkodra and Pogradec, with the topic: "Public awareness on Deposit Insurance in Albania". The workshops aimed at raising the level of understanding of the protection mechanism of the safety net player in Albania. Along with the general overview on the issues regarding deposit insurance and respective developments, some other important issues were presented and discussed, such as:

- Deposit Insurance in Albania from the viewpoint of public information and education,
- Registering and safekeeping of bank's deposit & depositor data, for deposit insurance and compensation purposes;
- Methodology for calculating the annual premium and compensation amount, for bank deposit insurance,
- Albanian legislation on deposit insurance and the international perspective.

Aktivitetet brenda vendit & Seminare

Sekretariti i AAB, si pjesë të aktivitetit të tij, organizoi, apo bashkëorganizoi një sërë aktivitetesh dhe seminaresh brenda vendit, si më poshtë:

Seminar i përbashkët AAB – Banka e Shqipërisë, mbi grupin e rregulloreve të transparencës bankare

AAB dhe Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë organizuan në 23 qershor 2008, një takim-diskutimi mbi disa projektregullore, të përgatitura nga Banka e Shqipërisë, si më poshtë:

- "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare",
- "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja".

Takim-diskutimi u përqendrua në temat e mëposhtme:

- Metoda e llogaritjes së interesit efektiv;
- Ndryshimet e propozuara, lidhur me zbatimin e masave për administrimin e rrezikut të kredisë;
- Diskutimi i hapave dhe mundësive për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) nga bankat, metodat e ndjekura nga bankat, lidhur me zbatimin e tyre dhe rëndësia e raportimit të kujdesshëm.

Takim-diskutimet rajonale të ASD dhe AAB: "Ndërgjegjësimi i Publikut mbi Sigurimin e Depozitave në Shqipëri".

AAB dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) organizuan, gjatë vitit 2008, pesë takim-diskutime trajnuese me punonjës bankash, respektivisht në: Tiranë, Vlorë, Sarandë, Shkodër dhe Pogradec, me temë: "Ndërgjegjësimi i Publikut mbi Sigurimin e Depozitave në Shqipëri". Qëllimi i këtyre takimeve ishte rritja e nivelit të të kuptuarit të mekanizmit të mbrojtjes të depozituesit shqiptar. Përveç aspekteve të përgjithshme mbi çështjet e sigurimit të depozitave, në takim u trajtuan e u diskutuan dhe çështje të tjera të rëndësishme, si:

- Sigurimi i depozitave në Shqipëri në këndvështrimin e edukimit dhe informimit të publikut;
- Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave për depozituesit & depozitat, për qëllime të sigurimit dhe kompensimit;
- Metodologjia e përlogaritjes së primit të sigurimit dhe shumës së kompensimit për efekt të sigurimit të depozitave;
- Legjislacioni shqiptar për sigurimin e depozitave dhe perspektiva në rrafsh ndërkombëtar.

AAB - IFC joint training seminars in Tirana, ALBANIA

The International Finance Corporation (IFC), in partnership with the Albanian Association of Banks (AAB), offered two training seminars for banks' employees:

1. Loan Officer Training

The first course, Loan Officer Training, a three-day course, was held on 29-31 May, 2008. The "Loan Officer Training" course was focused on the main issues and topics of loan making and its respective administration, like:

- Mortgage Products and the Inherited Risks,
- Marketing and Customer Screening,
- Pre-Application and effective interviewing techniques,
- The Application Process and File Building,
- Financial Analysis of the Borrower and Underwriting,
- Closing Procedures,
- Loan Monitoring and Servicing,
- Case studies and exercises.

2. Risk Management Training

The "Risk Management Training" course was a two-day course held on 6-7 June, 2008. The course was focused on the main issues and topics of the individual level management and portfolio management. Specifically, the key issues addressed at the course were as follows:

A- Individual Level

- Collateral Management,
- Delinquency Management.

B- Portfolio Level

- Capital and Credit Portfolio Management in Albanian Banks:
 - a- Risk Management;
 - b- Measuring and Managing Credit Risk;
 - c- Blending Risk and Returns;
 - d- Risk Components of Risk Pricing;
 - e- Risk Rating,
- Specific Credit Risk in Mortgage Lending,
- Credit Scoring,
- Operational Risk Management,
- Basel II.

At the seminars, bank were provided with IFC Mortgage Toolkit, a set of Industry Best Practices from around the world adapted to the needs of the Albanian banking sector.

Seminaret e përbashkëta trajnuese të AAB dhe IFC në Tiranë

Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe AAB organizuan dy seminare trajnuese për punonjësit e bankave:

1. Trejnimi i Punonjësve të Kredisë

Ky ishte një seminar trajnimi tre ditor 29-31 maj 2008 dhe u përqendrua në në temat dhe çështjet kryesore që lidhen dhënien e huave hipotekare dhe administrimin respektiv të tyre, si:

- Produktet e huasë hipotekore dhe rreziqet që shoqërojnë atë,
- Marketingu dhe përzgjedhja e klientit,
- Procesi i para aplikimit dhe teknikat efektive të intervistimit,
- Procesi i aplikimit dhe krijimi i dosjes,
- Analiza e gjendjes financiare të huamarrësve,
- Procedurat e mbylljes,
- Monitorimi dhe shërbimi i huasë,
- Raste studimore dhe ushtrime.

2. Trejnim mbi Administrimin e Rrezikut

Ky kurs u zhvillua në 6-7 qershor 2008 në Tiranë dhe u fokusua kryesisht në temat dhe çështjet kryesore që lidhen me administrimin e rrezikut në nivel individual si dhe me çështje të administrimit të portofolit. Çështjet kryesore të trajtuara në të ishin:

A- Nivel individual

- Administrimi i kolateralit,
- Administrimi i fenomenit të moskthimit të huave.

B- Nivel Portofoli

- Administrimi i portofolit të kredisë dhe kapitalit në bankat shqiptare:
 - a- Administrimi i rrezikut;
 - b- Matja dhe administrimi i rrezikut të besueshmërisë;
 - c- Kombinimi (ballafaqimi) i rrezikut me kthimet (të ardhurat);
 - d- Elementët përbërës në përcakimin e vlerës së rrezikut;
 - e- Klasifikimi (gradimi) i rrezikut,
- Rreziku specifik i besueshmërisë që lidhet me huatë hipotekore,
- Klasifikimi i besueshmërisë,
- Administrimi i rrezikut operacional,
- Bazel II.

Në seminar, bankave iu ofrua dhe "Manuali i IFC-së për Huanë Hipotekore", që përmbledh Praktikat më të Mira ndërkombëtare, të përshtatura sipas nevojave të sektorit bankar shqiptar.

Presenting MOODY's products for Albanian banks.

AAB co-organized and facilitated the first presentation of MOODY's in Tirana on 13 March 2008, where 9 banks attended it. At the meeting, MOODY's presented the products and services, which could be available to Albanian banks in this regard.

Presentation & workshop on FASTIP Dual Faculty Program in Durrës

AAB, in cooperation with GTZ, University "Aleksandër Moisiu", Durrës and Berufsakademie in Mosbach, GERMANY, organized on 21 April 2008 the workshop: **"FASTIP- Dual Faculty Program at University of Durrës"**.

The workshop was mainly focused on presenting and introducing the new Dual (Faculty) Study Program, at University of Durrës, supported by GTZ and Berufsakademie in Mosbach, GERMANY, as an autonomous Dual Faculty (theoretical and practical), which leads to the Bachelor of Arts with 180 Credits (3+2), according to the European Credit Transfer System (ECTS).

AAB – LGPA (USAID) joint technical workshop on local borrowing

AAB, in cooperation with USAID Local Governance Program in Albania (LGPA), organized a half-day technical meeting: **"On Municipal Borrowing Issue with Commercial Banks in Albania"**, in Tirana, on 25 June, 2008.

The meeting followed the approval in February 2008 of the Law **"On Local Government Borrowing"**, and the LGPA representatives delivered technical explanations about the law and the subsequent implementing provisions as well as the capacities and the limitations of the municipalities where LGPA Program will focus its assistance.

Prezantimi i produkteve të MOODY's për bankat shqiptare.

AAB bashkëorganizoi dhe ndihmoi në prezantimin, për herë të parë në Shqipëri, të produkteve të MOODY's në Tiranë, në 13 mars 2008. Në këtë prezantim morën pjesë përfaqësues nga 9 banka dhe përfaqësuesit e shoqërisë MOODY's prezantuan produktet dhe shërbimet që ajo mund të ofrojë për bankat në Shqipëri.

Takim pune për prezantimin e Programit të Fakultetit Dual në Durrës.

AAB, në bashkëpunim me GTZ, Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës dhe Berufsakademie në Mosbach, Gjermani, organizoi në 21 prill 2008 një takim pune me temë: **"FASTIP - Programi i Fakultetit Dual në Universitetin e Durrësit"**.

Ky takim pune u fokusua kryesisht në prezantimin e Programit të Studimeve Duale në Universitetin e Durrësit, si një program studimesh të larta, ku ndërthuret teoria me praktikën dhe që në fund studentët pajisen me diplomë universitare me 180 Kredite (3+2), në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).

Takim-diskutimi i përbashkët midis LGPA (USAID) dhe AAB mbi huamarrjen vendore

AAB, në bashkëpunim me Programin e USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA), organizoi në Tiranë në 25 qershor 2008, një takim-diskutimi teknik me temë: **"Diskutime mbi çështjen e huamarrjes vendore me bankat tregtare në Shqipëri"**.

Takimi u mbajt në vijim të miratimit nga Kuvendi, në shkurt 2008, të ligjit **"Për huamarrjen vendore"**, dhe përfaqësuesit e LGPA-së kryen prezantime dhe dhanë shpjegime teknike mbi mundësitë dhe kufizimet që kanë bashkitë, që ndihmohen aktualisht nga LGPA, për të hyrë në tregun e huamarrjes bankare.

International Events & Presentations

AAB attended the following international events:

9th InterBalkan Forum of Banking Associations (IFBA) meeting in Podgorica, Montenegro

The 9th InterBalkan Forum of Banking Associations (IFBA) meeting was held in Podgorica, Montenegro on Friday, 09 May 2008. AAB attended it with its Chairman Mr. Edvin LIBOHOVA and Secretary General Dr. Elvin MEKA, where the following topics were discussed:

- Economy and the Banking Sector in Montenegro – presentation.
- Role and the Significance of Supervision through the experience of the Central Bank of Montenegro.
- Deposit Insurance in Montenegro,
- The Montenegrin Banking Sector,
- Current Challenges of the EU Banking Sector,
- Prevention of Money Laundering and Terrorist Financing – presentation.
- Current Developments in the Regulatory Framework of the European Banking System

Attending the Crans Montana Forum 15-17 May 2008 in Tirana, ALBANIA

AAB attended with its Secretary General the discussion panel of Crans Montana Forum, which was held in Tirana on 15-17 May 2008.

Hosting and organizing EBF Meetings of the Executive Committee and of the Associates, 5-6 June 2008 in Tirana.

AAB, as an EBF Associate Member, upon approval of EBF Secretariat and prior approval of AAB Assembly (July 2006), hosted and organized, for the first time, the EBF Meetings of Executive Committee and of the Associates, respectively on 5 and 6 June 2008, in Tirana.

At EBF Meeting of the Associates, AAB Secretary General delivered the presentation: "**ALBANIA - Economy and Banking System - 2007**"³.

Aktivitetet dhe Prezantime Ndërkombëtare

Gjatë 2008-ës, AAB mori pjesë dhe në aktivitetet e mëposhtme ndërkombëtare:

Takimi i 9-të i Forumit Ndërbalkanik të Shoqatave të Bankave (IFBA) u mbajt në Podgoricë, Mali i Zi

Në takimin e 9-të të Forumit Ndërbalkanik të Shoqatave të Bankave (IFBA) në Podgoricë, Mali i Zi, në 09 maj 2008, AAB mori pjesë me Kryetarin e saj z. Edvin Libohova dhe Sekretarin e Përgjithshëm, Dr. Elvin MEKA, në të cilin u diskutuan çështjet e mëposhtme:

- Ekonomia dhe sistemi bankar malazez (prezantim),
- Roli dhe rëndësia e mbikëqyrjes, sipas eksperiencës së Bankës Qendrore të Malit të Zi,
- Sigurimi i depozitave në Malin e Zi,
- Sektori bankar malazez,
- Sfidat aktuale me të cilat përballë sektori bankar në vendet e BE-së,
- Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (prezantim),
- Zhvillimet më të fundit në kuadrin rregullator të sistemit bankar evropian.

Pjesëmarrja në Forumin e Crans Montana-s në 15-17 maj 2008 në Tiranë

AAB mori pjesë me Sekretarin e Përgjithshëm, në panelin e diskutimeve të Forumit të Crans Montana-s, të mbajtur në Tiranë, nga 15-17 maj 2008.

AAB organizon mbledhjet e rradhës të Komitetit Ekzekutiv dhe të Anëtarëve të Asociuar të Federatës Evropiane të Bankave (EBF) në Tiranë, 5-6 qershor 2008.

AAB, si anëtare e asociuar e EBF-së priti dhe organizoi, për herë të parë në Tiranë, në 5 dhe 6 qershor 2008, mbledhjet e rradhës të Komitetit Ekzekutiv dhe të Anëtarëve të Asociuar të EBF-së.

Në takimin e Anëtarëve të Asociuar të EBF-së në 5 qershor 2008, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, mbajti prezantimin: "**SHQIPËRIA – Ekonomia dhe Sistemi Bankar 2007**"³.

³ Please click on the following link to download the presentation: "ALBANIA – Economy and Banking System 2007": <http://www.aab.al/eng/documents/ALBANIA-EconomyandBankingSystem2007-26thEBFAssociatesMeeting.ppt>

³ Klikoni në lidhjen e mëposhtme për të shkarkuar prezantimin: "SHQIPËRIA – Ekonomia dhe Sistemi Bankar 2007" <http://www.aab.al/eng/documents/ALBANIA-EconomyandBankingSystem2007-26thEBFAssociatesMeeting.ppt>

Attending and co-organizing the First International Conference on the Real Estate Development in Albania, 13 - 14 May, 2008, in Tirana, ALBANIA

AAB supported, as one of patrons, the First International Conference on the Real Estate Development in Albania, on 13 - 14 May 2008, in Tirana, organized by IkubINFO Business Advisory, in cooperation with Filipovic Business Advisory Ltd. (CROATIA).

The Conference provided analysis of current situation of real estate development in Albania. Conference speakers were members of Albanian government and other state bodies and entities, representatives of international organizations and professional associations, legal, financial and development experts and representatives of the investors, banks and investment funds.

AAB Secretary General delivered the presentation: **“Banks and real estate - Issues and prospects”**⁴.

*Presentation: “Albania – Economy and the Banking System 2008” at BACEE Conference*⁵

